

TRANSICIONI DEMOGRAFIK NË KOSOVË
sfidat dhe mundësitë në botën me
7 miliard njerëz

Norma e fertilitetit në Kosovë (përspektiva gjinore)

Dr. Mimoza DUSHI

Prishtinë, 03.11.2011

Përmbajtja

- Hyrje (Teoria e Transicionit demografik dhe Transicioni i dytë demografik)
- Transicioni demografik në Kosovë
- Ndryshimi i nivelit të natalitetit
- Gatishmëria e femrave në shoqërinë kosovare që të planifikojnë familjet e tyre
- Përfundim


Hyrje

- ndryshimet e natyrës socialo-ekonomike shkaktojnë transformime në zhvillimin demografik, posaqërisht në determinantet e lëvizjes natyrore
- Teoria e transicionit demografik - ekuilibrimi në mes shkallës së mortalitetit (nën 30 promilë) dhe natalitetit (nën 30 promilë)
 - shkalla e fertilitetit në nivel të zëvendësimit
 - martesë
 - mjete tradicionale të kontrollit të lindjes
- Transicioni i dytë demografik (Van de Kaa, 1988)
 - shkalla e fertilitetit në nivel të zëvendësimit
 - kohabitimi
 - mjete moderne të kontrollit të lindjes

Transicioni demografik në Kosovë

- në shoqërinë shqiptare në Kosovë rrjedha demografike shënon një transformim, kalim nga shoqëria paratransicionale në atë transicionale
- në shoqërinë paratransicionale
 - shkalla e fertilitetit ishte shumë e lartë
 - degë kryesore të ekonomisë ishin bujqësia e blegtoria
 - kërkohej numër i madh i fuqisë punëtore (përfshirë fëmijët)
 - femra duhej të lindte pandërprerë

- shkalla e mortalitetit të përgjithshëm bie nën 30 promilë, në vitet e 20-ta




Ndryshimi i nivelit të fertilitetit

- pas Luftës së Dytë Botërore, nuk vërehen ndryshime të menjëhershme
 - Kosova ende kishte shkallën më të lartë të natalitetit në Evropë, me afër 50 promilë mesatarisht në vit
 - për afërsisht me tetë fëmijë për grua
- shoqëria kosovare shqiptare të vazhdoj të mbetet agrare
 - ruheshin normat e familjes patriarkale dhe shoqërisë tradicionale

- investime në ekonomi (në industrinë e rëndë)
 - nevojitej fuqi punëtore mashkullore
 - inkuadrim i pamjaftueshëm i femrës në proceset ekonomike
 - vazhdim i mbylljes së saj brenda suazave shtëpiake
 - kohë të mjaftueshme të merret me lindjen dhe rritjen e fëmijëve
 - mbetet e lidhur me funksionin biologjik të saj, lindshmërinë


- pas viteve të 60-ta
 - fillojnë investimet në ekonomi (industrinë e lehtë)
 - mundësi femrave të përfshihen në proceset socio-ekonomike
- mirëpo, numri i madh i lindjeve tregon se nuk ka ndryshime të mëdha ekonomike dhe demografike
 - e vetmja gjë është zvogëlimi i shkallës së mortalitetit infantil, derisa shkalla e fertilitetit mbetet e njejtë
 - në këtë kohë shënohet shtimi më i madh natyror për popullatën shqiptare në Kosovë

- shkalla e fertilitetit nën 30 promila në gjysmën e dytë të shek. XX



- ndryshimet reale ndaj lindjes dhe numrit të pasardhësve fillojnë tek pas vitit 2000
 - migrimet fshat – qytet (veçanërisht pas konfliktit të vitit 1999)
 - ndryshim i strukturës urbane të vendit
 - ndryshim i ekonomisë
 - sektorët primar zëvendësohen me sektorët terciar
- krijohen kushte më të favorshme për punësimin e femrës
 - ka arritur një shkallë të pavarësisht ekonomik dhe individual
 - qëllim i saj kryesor nuk është më lindja dhe rritja e fëmijëve, por përparimi në karrierë dhe shfrytëzimi i kohës së lirë
- rritet kërkesa për fuqi punëtore të kualifikuar
 - largon fëmijët nga procesi i punës

- kjo situatë spontanisht imponon nevojën për planifikim të familjes
 - hyrje e vonshme në martesë
 - numër më i vogël i fëmijëve
 - përdorim i mjeteve të ndryshme për parandalim të shtatzënësive



Gatishmëria e femrave në shoqërinë kosovare që të planifikojnë familjet e tyre

- koncepti është i lidhur me dy kategori të pyetjeve, ato për
 - planifikim të familjes
 - aftësia e femrës për vendimarrje
- analizuar sipas
 - variabla demografike
 - moshë dhe statusi martesor
 - variabla socio-ekonomike
 - niveli i edukimit, punësimi, lartësia e të ardhurave dhe tipi i vendbanimit

- planifikimi i familjes
 - në aspektin ekonomik - mundëson planifikimin e numrit të fëmijëve në harmonizimin me të ardhurat materiale të familjes
 - në aspektin shoqëror - është metodë parandaluese për lindjet e paplanifikuara, e sidomos për shmangien e aborteve
 - në planin mjekësor - përfaqëson metodat kurative në masën e trajtimit të sterilitetit
- aborti – metodë e ndërprerjes së shtatzënësive
- mjetet kontraceptive – metodë e parandalimit të shtatzënësive të paplanifikuara

Variablat demografike

- ndikim më të madh në përdorimin e kontraktivëve, te femrat, ka statusi martesor dhe kohëzgjatja në te
 - femrat e moshuara edhe që janë të martuara aplikojnë më shumë kontrollin e lindjes se sa ato të moshës së re dhe të pamartuara
 - femrat e moshës së re mund të kenë pasoja në shtatzënësitë e tyre të ardhshme
 - femrat në moshë kanë arritur numrin e dëshiruar të fëmijëve

Variablat socio-ekonomike

- femrat e shkolluara dhe të punësuarat të cilat kanë arritur të sigurojnë një bazë ekonomike
 - marrin pjesë aktive në çështjet mbi planifikimin e familjes
 - koordinojnë kohën të cilën e shpenzojnë në punë dhe me familjet e tyre
- të pashkolluara dhe të papunësuarat kanë status më të ulët social, jetojnë kryesisht në vendbanime rurale dhe në familje të mëdha
 - nuk kanë qëndrime të qarta mbi sjelljen riprodhuese
 - familjet e tyre “planifikohen” nga bashkëshortët

- femrat e shkolluara dhe të punësuara kryesisht jetojnë në vendbanime urbane
- analiza tregon rëndësinë e pozitës në profesion dhe nivelit të të ardhurave mujore
 - pozitë më e mirë në punë + të ardhura më të larta mujore = numër më i vogël i fëmijëve

Përfundim

- sjellja riprodhuese të femrat shqiptare në Kosovë është duke ndryshuar
 - në varshmëri me pozitën e femrës në shoqëri
- ndryshimi i sjelljes riprodhuese individuale patjetër se reflektohet në nivelin shoqëror
 - përcaktimi i femrës për numër më të vogël të fëmijëve dalëngadalë do të ndryshojë normën e fertilitetit të përgjithshëm
- nevojitet një transformim më i madh mbarëshoqëror
 - niveli i tashëm i emancipimit të femrës në shoqërinë shqiptare në Kosovë nuk duket i mjaftueshëm aq sa të ndryshojë qëndrimet mbi lindshmërinë në formë masive
 - edhe për një kohë profesionet kryesore të femrës do të vazhdojnë të mbesin amvisëria dhe prindëria

Faleminderit!